

RREGULLORE

Nr._____, datë _____.____.2010

PËR LICENSEN E PËRGJITHSHME PER OFRIMIN E SHERBIMEVE POSTARE

Në mbështetje të shkronjave b) dhe c) të nenit 7/1, e vijues të Ligjit Nr.8530, date 23.09.1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin Nr.10132, date 11.05 2009, si dhe të shkronjës p) të nenit 8, dhe pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

KËSHILLI DREJTUES I AKEP VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

1. AKEP administron dhe jep licensat e përgjithëshme, për ofrimin e shërbimeve postare që nuk përfshihen në shërbimin bazë postar.
2. Kjo Rregullore, përcakton kushtet procedurën dhe pagesat për dhënien e “Licensave të Përgjithshme”, në zbatim të shkronjës c) të nenit 7/1 të ligjit nr.8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.(këtu e më poshtë Ligji 8530)
3. Dhënia e “Licensave të Përgjithshme” nga AKEP bëhet në përputhje me Ligjin “Për shërbimin Postar në RSH”, i ndryshuar dhe rregulloreve të AKEP dhe/ose rekomandimeve të organizmave përkatës postar ndërkombëtare.

Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Subjektet fizike apo juridike mund të ofrojnë shërbime postare, që nuk përfshihen në shërbimin bazë postar, vetëm pasi të jenë pajisur nga AKEP me “Licensë të Përgjithshme”.
2. “Licensa e Përgjithshme” përfshin të gjithë ose pjesë të stadeve të grumbullimit, sortimit, transportimit, shpërndarjes dhe dorëzimit të objekteve postare. Shërbimet postare që kryhen sipas kësaj Rregulloreje janë:

- a. Shërbimi special i dorëzimit të objekteve postare të postës së shpejtë- Posta Expres;
- b. Shpërndarja e objekteve të paadresuara për publicitet;
- c. Përgatitja e objekteve postare;
- d. Shërbime të tjera të kërkuara nga aplikuesi dhe të gjykuara nga AKEP.

KREU II PROCEDURA, KUSHTET DHE VLEFSHMËRIA

Neni 3 Procedura

1. Për t'u pajisur me "Licensë të Përgjithëshme", cilido person fizik apo juridik, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.8530, përcaktimet në këtë rregullore, do të plotësojë Formularin e Aplikimit për t'a paraqitur në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (këtu – e mëposhtë AKEP-i). Formulari i Aplikimit për pajisjen me "Licensë të Përgjithëshme" për ofrimin e shërbimit postar do të plotësohet nga web: www.akep.al.

2. Dokumentacioni mbështetës në lidhje me plotësimin e formularit për ofrimin e shërbimeve postare do të jetë si më poshtë;
 - a) Një deklaratë se personi ka kapacitete profesionale. Kapacitetet profesionale konsistojnë në pasjen e njohurive për sigurimin e nje niveli të përshtatshëm të nivelit të cilësisë për ofrimin e shërbimeve postare.
 - b) Listën e cmimeve që do aplikoj për ofrimin e shërbimeve postare

3. AKEP do të shqyrtojë aplikimin dhe do të vendose të jape "Licensën e Përgjithëshme" ose arsyeton për refuzimin e dhënies brenda 30 ditëve nga plotësimi i formularit dhe dokumentacionit të kërkuar (i plotësuar sipas kërkesave të rregullores Ankesi 1). Nëse formulari ose dokumentacioni paraqitet jo i plotë atëherë ai do rikthehet për t'u riplotësuar.

4. "Licensa e Përgjithëshme" do të përmbajë informacionin e mëposhtëm;
 - a. Autoritetin që ka lëshuar "Licensën e Përgjithëshme";
 - b. Numrin dhe datën e "Licensës së Përgjithëshme";
 - c. Emrin dhe adresën e personit fizik ose juridik të cilit i është dhënë "Licensa e Përgjithëshme";
 - d. Të drejtën e dhënë nëpërmjet kësaj "License të Përgjithëshme";
 - e. Territorin, në të cilin është dhënë e drejta e ofrimit të shërbimeve postare;
 - f. Afati i mbarimit të "Licensës së Përgjithëshme";
 - g. Kërkesat për pagesat e miratuara nga AKEP; dhe
 - h. Kërkesa të tjera, të cilat lidhen me ofrimin e shërbimeve postare.

5. AKEP do të rregjistrojë ofruesin e Licensuar në regjistrin e përcaktuar për këtë qëllim. Regjistri do të jetë i disponueshëm edhe elektronikisht.
6. AKEP do të publikojë listën e ofruesve të shërbimeve postare, të cilëve iu është dhënë “Licensë e Përgjithëshme” në faqen e web të tij.
7. AKEP do të vendosë të refuzojë dhënien e “Licensës e Përgjithëshme” për ofrimin e shërbimit postar vetëm nëse ndodhemi në kushtet e mëposhtëme:
 - Aplikuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të Rregullores;
 - Dokumentat e paraqitur nuk plotësojnë kërkesat e kësaj rregulloreje;
 - Janë paraqitur informacione fallco.

Neni 4

Kushtet Kryesore për Ofrimin e Shërbimeve Postare

1. Personi fizik ose juridik do të ofrojë shërbimet postare vetëm pasi të jetë pajisur me “Licensë të Përgjithëshme” të dhënë nga AKEP.
2. “Licensa e Përgjithëshme” nuk mund t’ju transferohet personave të tjerë pa miratimin paraprak të AKEP.
3. Ofruesi i shërbimeve postare duhet të publikojë;
 - a. Rregullat për ofrimin e shërbimeve postare,
 - b. Llojet e shërbimeve postare;
 - c. Tarifat e shërbimeve të ofruara;
 - d. Afatet kohore të dorëzimit të dërgesave postare;
 - e. Detyrimet e parashikuara nga ofruesit e shërbimit postar,
 - f. Procedurat e shqyrtimit të reklamimeve dhe kompensimet për dëmtim;
 - g. Rregullat për mbledhjen, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e dërgesave postare.
4. Të sigurojnë konfidencialitetin e korrespondencës.
5. Të dorëzojnë në pikat postare, drejtuar në vendin e punës apo të studimeve të një personi, vendin e banimit, vendi i shërbimit ushtarak, në spital, sanatorium, në kamp apo vend të burgimit për administratën ose personat e autorizuar prej tij.
6. Të evidentojë çmimin e një njësie të çdo shërbimi të ofruar postar dhe numrin e njësisive të çdo shërbimi të ofruar postar në faturat e hartuara me përdoruesit.

7. Ofruesit e shërbimeve postare, duhet të sigurojnë ofrimin e tarifave, duke patur parasysh përcaktimet e Këshillit të Minsitratave “Për përcaktimin e tarifës dhe peshës së shërbimeve të rezervuara për Operatorin Publik Postar”.

Neni 5

Vlefshmëria e Licensës së Përgjithëshme

1. Licensa e Përgjithëshme do te jepet për një periudhë 10 vjecare me të drejtë rinovimi.
2. Aplikimet për rinovimin e “Licensës së Përgjithëshme” do te bëhen jo më pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë përpara përfundimit të vlefshmërisë së tij, bazuar në legjislacionin ne fuqi të periudhës.

KREU III

TRANSFERIMI, NDRYSHIMI DHE REVOKIMI

Neni 6

Transferimi i Licensës së Përgjithëshme

1. Transferimi i “Licensës së Përgjithëshme” për ofrimin e shërbimeve postare, bëhet vetëm me miratim nga AKEP, pas kërkesës me shkrim nga mbajtësi i Licensës, dhe vetëm nëse personi fizik ose juridik, të cilit kërkohet t’i kalohet kjo “Licensë e Përgjithëshme” përmbush kërkesat e ligjit nr. 8530 dhe rregullat përkatëse, të zbatueshme nga AKEP-i.
2. Të Licensuarit, i cili kërkon transferimin e “Licensës së Përgjithëshme” për ofrimin e shërbimeve postare një subjekti tjetër, nëse AKEP pranon transferimin, i hiqen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e “Licensës së Përgjithëshme” me të cilin ishte pajisur dhe i kalojnë të Licensuarit të ri.
3. Transferimi i “Licensës së Përgjithëshme”, do të bëhet nga AKEP, vetëm nëse jane shlyer pagesat përkatëse nga i Licensuari (mbajtës i “Licensës së Përgjithëshme”) deri në momentin që kërkon transferimin.

Neni 7

Ndryshimet në Licensën e Përgjithëshme

1. AKEP-i mund të ndryshojë Licensën e Përgjithëshme :
 - a. Nëse kjo kërkohet nga i Licensuari,
 - b. Nëse pëson ndryshime legjislacioni për shërbimin postar ,

- c. Në zbatim të akteve ndërkombëtare, të detyrueshme për zbatim në Republikën e Shqipërisë.
2. Në rast ndryshimi të emrit të të Licensuarit dhe/ose pronarëve të tij, i Licensuari bën me dije me shkrim AKEP, por jo më vonë se 30 ditë dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës që vërteton ndryshimin. AKEP brenda 30 ditëve kryen ndryshimet në “Licensën e Përgjithëshme” të mëparshme dhe e ripajis sipërmarrësin me “Licensën e Përgjithëshme”. Në këtë rast, koha e vlefshmërisë së “Licensës së Përgjithëshme” nuk ndryshon.
3. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të mësipërme, AKEP-i lëshon një “Licensë të Përgjithëshme”, e cili përfshin ndryshimet.

Neni 8 **Revokimi i Licensës së Përgjithëshme**

1. AKEP-i revokon “Licensën e Përgjithëshme” me kërkesën e të Licensuarit.
2. AKEP-i, me vendim të Këshillit Drejtues revokon një “Licensë të Përgjithëshme” me nismën e vet, në rast se vërteton që:
 - a) I Licensuari ka përfituar “Licensën e Përgjithëshme” duke dorëzuar të dhëna falso, dokumenta të falsifikuar ose ka fshehur fakte;
 - b) I Licensuari ka shkelur dispozitat e ligjit 8530;
 - c) I Licensuari nuk ka zbatuar kushtet e Licenses se Përgjithëshme;
 - ç) I Licensuari është likujduar.
 - d) Nuk ushtron (fillon) aktivitetin, e caktuar në “Licensën e Përgjithëshme”, brenda një viti nga dita e marrjes se Licensës së Përgjithëshme
 - dh) I licensuari ka përdorur “Licensën e Përgjithëshme” për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në Licensë .
 - e) I Licensuari nuk ka zbatuar urdhërat e AKEP për të eliminuar mangësitë e konstatuara nga AKEP, brenda afatit të përcaktuar.
 - f) I Licensuari nuk ka kryer pagesat për “Licensën e Përgjithëshme” brenda 30 ditëve nga afati i përcaktuar ose 15 ditë pas njoftimit nga AKEP.

Neni 10 **Pagesat për Licensën e Përgjithëshme**

Për ushtimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve postare sipas “Licenses së Përgjithëshme” të Licensuarit duhet të bëjnë pagesat pranë AKEP.

Pagesat për “Licensën e Përgjithëshme” janë vjetore dhe kryhen brenda datës 31 mars të vitit në vazhdim si më poshtë;

“Licensë e Përgjithëshme” për ofrimin e shërbimeve postare 30.000 lekë /vit

Neni 11

Raportimi për shërbimet postare të ofruara

Ofruesit e shërbimeve postare do raportojnë peridikisht në AKEP ne periudha 6-mujore (deri me 31 Shtator te vitit në vazhdim dhe deri me 31 Mars te vitit pasardhës);

Në raportim do të përfshihen ndër të tjera;

- a. Lista e emrave dhe adresat e pikave të grumbullimit, në territorin e shërbimit, tarifrat e shërbimeve postare dhe mostrat e identifikimit të dërgesave postare (vulë, etiketë, faturë, etj), të vlefshme në fund të ciklit të raportimit.
- b. Ofruesi i shërbimeve postare do t'i paraqesë AKEP-it edhe cdo informacion tjetër ose të dhëna të nevojshme, për qëllime statistikore, hulumtim të tregut ose kryerjen e detyrave të tjera dhe funksionet e AKEP, deri në fund të periudhës së përcaktuar nga AKEP, nese AKEP e kerkon këtë gjë me shkrim.

AKEP do të analizojë, përmbledh dhe publikjë (në botimet/webpage/raportet e AKEP, etj) përmbledhje informacioni, në lidhje me veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve postare.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

Neni 11

Shfuqizimi

1. Me hyrjen ne fuqi te kësaj Rregulloreje Udhëzimi i Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit Nr. 2181 datë 28.06.2002 “Procedurat për dhënie license dhe leje për operimin në sektorin postar në Republikën e Shqipërisë si dhe proceduat e ofrimit te shërbimeve postare” shfuqizohet.

Neni 16

Dispozitat Tranzitore

1. Të gjitha licensa e lëshuara në mbështetje të Udhëzimit nr. 2181 datë 28.06.2002 “Procedurat për dhënien e license dhe leje për operimin në sektorin postar ne R.SH”

do të transpozohen sipas rregullores së re të miratuar, jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Hyrja në Fuqi

Rregullorja do të hyjë në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Këshilli Drejtues i AKEP-it.

FORMULAR**PER OFRIMIN E SHERBIMEVE POSTARE NEN REGJIMIN E LICENCES SE PERGJITHSHME**

<input type="checkbox"/>	Fillim aktiviteti/veprimatrie	<input type="checkbox"/>	Ndryshimi i te dhenave te shoqerise (Adrese, selie, perfaqesuesi ligjor etj.)
<input type="checkbox"/>	Rinovimi i Licenses kzistuese	<input type="checkbox"/>	Ndryshimi i te dhenave te rrjetit
<input type="checkbox"/>	Mbyllje e aktiviteti/veprimatrie	<input type="checkbox"/>	
<input type="checkbox"/>	Ndryshimi i sherbimeve te ofruara	<input type="checkbox"/>	

A. TE DHENA MBI SHOQERINE

EMERTIMI :		Numri i regjistrimit ne AKEP:	
(Vetem per shoqerite qe jane te regjistruara)			
EMERI i AKRONUAR:			
SELIA E SHOQERISE:			
(RRUGA/ NUMRI, KODI POSTAR, QYTETI, PREFEKTURA, VENDI)			
NIPT.:	TEL:	FAX:	
Kodi Fiskal:	E-mail:	Website:	
Fillimi nga:	Ndryshimi nga:	Mbyllja nga:	

ADRESA E KOMUNIKIMIT. (ne rast se eshte e ndryshme nga selia e shoqerise)

RRUGA / NUMER, KODI POSTAR, QYTETI, PREFEKTURA, VENDI :	TEL – FAX:	E-mail:
---	------------------	---------------

B. FORMA JURIDIKE (Plotesohet me X apo me ✓ ne kutine respektive)

Person Fizik (Biznes personal) <input type="checkbox"/>	SH.KOL. <input type="checkbox"/>	SH.KOM <input type="checkbox"/>	SH.P.K <input type="checkbox"/>	SH.A <input type="checkbox"/>	TJETER: <input type="checkbox"/>
					(Plotesohet forma e shoqerise

C. LLOJI i LICENCES SE PERGJITHSHME TE KERKUAR (Plotesohet me X apo me ✓ ne kutine respektive)

LICENCE E PERGJITHSHME LOKALE (Sherbimet ofrohen brenda territorit te nje prefektуре) <input type="checkbox"/>	LICENCE E PERGJITHSHME RAJONALE (Sherbimet ofrohen ne territorin e 2 prefekturave deri ne 50% te prefekturave te vendit) <input type="checkbox"/>	LICENCE E PERGJITHSHME KOMBETARE (Sherbimet ofrohen ne mbi 50% te prefekturave) <input type="checkbox"/>
---	--	---

C. KOHEZGJATJA E LICENCES SE PERGJITHSHME TE KERKUAR

Numrin e Plote te viteve kalendarike te vlefshmerise se Licences se Pergjithshme duke perfshire dhe vitin ne vazhdim:
---	-------

D. SIGURIMI i KERKESAVE BAZE

(Plotesohet me X apo me ✓ ne kutine respektive)

Sigurimi i kerkesave baze ne perputhje me rregullimet e dispozitave te nenit 17, 30, 31 te Ligjit 8530"Per sherbimin Postar ne RSH", i ndryshuar	
PO <input type="checkbox"/>	JO <input type="checkbox"/>

E. PERFAQESUESI LIGJOR

Emri:	Mbiemri:	Numri kartes se identitetit / Numri i pasaportes:
Adresa (RRUGA/ NUMRI, KODI POSTAR, QYTETI, PREFEKTURA, VENDI)		Autoriteti qe e ka leshuar:
TEL:	FAX:	E-mail:

ANEKSI I (vazhdim)

(Sipas Rregullores se "Licencave te Pergjithshme" per ofruesit e sherbimeve postare).

Ë. TE DHENA TE SHOQERISE – RRJETIT POSTAR

a/a	NUMRI ne AKEP (*)	TITULLI i AKRONUAR	ADRESA (Rruga/Numri, . Qyteti, Prefektura)	TEL FAX	NUIP Kod. Fiscal	PREFEKTURA KU SHTRIHET SHERBIMI	ZYRA POSTARE (**)	QENDRA E perëpunimit (**)	AMBJENTE TE TJERA (**)	PERSONELI i PUNESUAR PLOTESISHT	PERSONELI i PUNESUAR PART TAIME	MOTOCI KLETA	AUTOMJETE	AUTOMJET TE TJERA
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
TOTALI														

Ne rast te mungeses se vendit te shtohet nje flete tjetër

(* Plotesohet vetem nese behet fjale per shoqeri postare qe diponon Licence te Pergjithshme e regjistruar ne rrjetin e shoqerive postare me Licence te Pergjithshme

(**Plotesohet me X apo me ✓ ne kutine respektive qe eshte e vlefshme)

ANEKSI I (vazhdim)

(Sipas Rregullores se Licencave te Pergjithshme per ofruesit e sherbimeve postare).

G. PERMBAJTJA E SHERBIMEVE POSTARE (Plotesohet nga shoqeria me X apo me ✓ kutite respective qe jane te vlefshme).	
1. Shërbim special i dorëzimit të objekteve të postës së shpejte, brenda vendit. <input type="checkbox"/>	1. Shërbim special i dorëzimit të objekteve të postës së shpejte, brenda vendit. <input type="checkbox"/>
3. Shpërndarje e objekteve të paadresuara për publicitet <input type="checkbox"/>	4. Përgatitje e objekteve postare <input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	5. Tjetër (Përkruaj). <input type="checkbox"/>



H. CERTIFIKATA, KONFIRMIME BASHKALIDHUR (Nuk aplikohet për shoqëri që gjenden të regjistruara në regjistrin e ofruesve të sherbimeve postare)	
a) PERSONA FIZIK	
1. Deklarata se aplikuesi ka kapacitete profesionale. <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. Lista e cmimeve që do të aplikohen për ofrimin e sherbimeve postare. <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

